




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë me Nr. 904, e datës 14.03.2023, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.05.2023, merr këtë:

## V E N D I M

**për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e vendimit për Planin Komunal të Veprimit për Energjinë dhe Klimën (PKVEK) 2022-2030, me Nr, 01-101/05-164, i datës 01.03.2023 dhe vendimin për Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) 2022- 2030, me Nr. 01-110/05-1364, i datës 05.12.2022**

### Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e vendimit për Planin Komunal të Veprimit për Energjinë dhe Klimën (PKVEK) 2022-2030, me Nr,01-101/05-164, i datës 01.03.2023 dhe vendimin për Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) 2022- 2030, me Nr.01-110/05-1364, i datës 05.12.2022.

### Neni 2

Shfuqizimi bëhet me kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë me Nr.904, e datës 14.03.2023.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryetari i Komunës së Vitisë dhe drejtoritë tjera të Komunës së Vitisë, do të kryejnë veprimet e tyre nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për relaizimin e këtij vendimi.

### Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI  
Bekim Azizi

